



Ville de Lausanne

Bureau lausannois  
pour les immigrés



# Jeta në Lozanë Udhërrëfyes praktik

SQ

# Lënda

Mirësevini në Lozanë	4
Integrimi na takon të gjithëve	5
Qyteti dhe fytyrat e tij	6
Lozana ju mirëpret	8
Mbërritja juaj: përçapjet që duhet të bëni	10
Vendndodhja e institucioneve bashkiake në planin e qytetit	12
Shkolla dhe rinia	14
Studimet dhe formimi	18
Puna	20
Shëndeti dhe ndihma shoqërore	22
Banesat dhe mbetjet	26
Jeta në lagje	28
Shtetësia dhe të drejtat politike	30
Kultura, argëtimet dhe sporti	32
Transportet dhe lëvizshmëria	34
Thelbësoret nga A-ja te Z-ja - përmbledhës i adresave	36

Botuesi: Qyteti i Lozanës, Bureau lausannois pour les immigrés – BLI, në bashkëpunim me zyrën Info Cité

Dizenjo: alafolie.ch

Fotografia e kapakut: Marino Trotta

Shtypja: Presses Centrales

Gusht 2019, botimi i 7-të

Me mbështetjen e:



# Mirë se vini në Lozanë

Lozana, qytet i hapur

Të administrosh një qytet do të thotë të kërlesh vazhdimisht të ruash baraspeshën midis qëndrueshmërisë dhe zhvillimit; do të thotë të pajtosh interesa nganjëherë të papajtueshme; do të thotë sidomos të kontribuosh për një marrëveshje sa më të harmonishme të mundshme midis banorëve dhe bashkësive që e përbëjnë atë. Këto çështje marrin një përmasë të veçantë në Lozanë, pasi qyteti ynë ka afër 43% të huaj dhe kjo përqindje rritet rregullisht. Shumëllojshmëria e origjinave kombëtare e shoqërore përbën një shans: ajo i pasuron kulturat e ndryshme, përmes shkëmbimeve midis tyre. Ajo e zgjeron kështu horizontin tonë.

Ajo na mëson si ta njohim e ta respektojmë njëri-tjetrin. Ajo mund të përbëjë edhe një brishtësi, nëse ne nuk arrijmë t'i përfshijmë të gjithë, duke respektuar kulturën e secilit.

Nëse Lozana ia ka dalë mbanë dhe ka arritur kështu të jetë një shembull hapjeje dhe shumëllojshmërie, kjo ka ndodhur pikërisht në saje të përpjekjeve të bëra, qysh prej shumë vitesh, nga BLI-ja dhe partnerët e saj. Me punën e tyre të përditshme – provë e së cilës është edhe kjo broshurë - ata kontribuojnë për ta bërë Lozanën një qytet gjithpërfshirës, i cili dëshiron të jetë mikpritës dhe përqipet që ta bëjë jetën të këndshme për të gjithë.




Grégoire Junod, kryetar i bashkisë së Lozanës

# Integrimi na takon të gjithëve

Në kryeqytetin vaudez takohen mbi 160 kombësi. Këtu, ndoshta më shumë se gjetkë, integrimi na takon të gjithëve, qofshim ne me shtetësi zvicerane apo të ardhur nga vende më të largëta. Tejkalimi i paragjytimeve, vendosja e kontakteve me fqinjët, çelja e dialogut me ta janë veprime të nevojshme për t'u njohur, për t'u kuptuar dhe për të jetuar më mirë së bashku. Për ata që sapo kanë ardhur, mësimi i frëngjishtes përbën etapën e parë për arritjen e një mëvetësie më të madhe. Duke u zotuar, secili në mënyrën e vet, për respektimin e njëri-tjetrit, ne garantojmë zbatimin e parimeve themelore që mundësojnë sigurimin e kompaktësisë shoqërore.

Lozana është e ndërgjegjshme se shumëllojshmëria paraqet edhe një sfidë në sigurimin e mundësive të barabarta për të gjithë. Më shumë se 43% e lozanezëve nuk e kanë pasaportën zvicerane. Qyteti ynë ka qenë i pari, në Zvicër, më 1971, që krijoi postin e një të ngarkuari me çështjet e të imigruarve.

Kështu, qysh prej gati 50 vjetësh, ai ndjek një politikë gjithpërfshirëse që mban parasysh nevojat e njerëzve. Ky botim është një shembull i bashkëpunimit të administratës komunale me shumë shoqata e organizma publike, i cili synon ta bëjë të kuptueshme politikën tonë të Pritjes. Ne u shprehim mirënjohjen tonë të gjithë atyre që kontribuojnë në këtë drejtim. Po ashtu, urimet tona më të mira ju shoqërojnë juve që sapo keni ardhur.



Oscar Tosato, këshilltar bashkiak  
Drejtor i sporteve dhe kompaktësisë shoqërore

# Qyteti dhe fytyrat e tij

Lozana, që është qyteti i katërt i Zvicrës, me 145.000 banorët e saj, ka një pamje të mrekullueshme mbi liqenin e Lemanit dhe Alpet. Ajo dallohet nga përkushtimet e saj të shumëllojshme, duke qenë njëkohësisht Kryeqytet olimpike, qytet i qëndrueshëm që mban parasysht interesat e tashme e të ardhme dhe qendër e njohur formimi e kulture. Rreth katedrales gotike të Lozanës jeton një popullsi e ardhur nga të gjitha anët; aty ndodhen edhe seli të shumë shoqërive shumëkombëshe.

## Kryeqytet olimpike e sportiv

Rëndësia e sportit në Lozanë del në pah edhe nga prania, qysh prej vitit 1914, e Komitetit ndërkombëtar olimpike (CIO), si dhe e rreth njëzetë federatave dhe organizatave sportive botërore. Ky status, si Kryeqytet olimpike, do të përfordhet edhe më tepër nga pritja që do t'u bëjë, në janar të vitit 2020, Lojërave olimpike dimërore të rinisë (IOJ), në të cilat do të marrin pjesë më shumë se 1000 atletë të moshës 15 deri në 18 vjeç.

Më 2019, Lozana përuroi një stadium të ri futbolli. Ajo ka sot disa qindra klube dhe shoqata, që mundësojnë praktikimin e më shumë se 70 sporteve të ndryshme. Çdo vit, atje zhvillohen veprimtari të mëdha sportive, si Atletisima (Athletissima), Maratona e Lozanës (Lausanne Marathon) apo edhe vrapimi popullor 20 kilometërsh i Lozanës (20KM de Lausanne).

## Pioniere në zhvillimin e qëndrueshëm

Qysh prej më shumë se njëzet vjetësh, Lozana e ka vendosur zhvillimin e qëndrueshëm, që mban parasysht interesat e tashme e të ardhme, në qendër të vëmendjes së saj. Përpjekjet e saj janë shpërblyer me çmimin e artë europian të energjisë (European Energy Award Gold). Ajo investon me qëllim që të garantojë furnizimin me elektricitet 100% të ripërtëritshëm. Banesat e reja i plotësojnë kriteret e Shoqërisë me 2000 vat. Ajo përkrah lëvizshmërinë e butë (si ecja në këmbë, me biçikletë) dhe i përkushton

një vend të gjerë natyrës në qytet. Metroja e saj m2 është metroja e parë automatike në Zvicër. Ndërkohë, janë duke u realizuar edhe dy eko-lagje të mëdha.

## Formim ekselence

Në Lozanë, janë të pranishme disa shkolla të larta të nivelit botëror, si Shkolla politeknike federale (EPFL) që është klasifikuar gjithmonë si një nga institucionet akademike më të mira në botë, Shkolla e hotelierisë (EHL), apo Instituti ndërkombëtar për administrim (IMD). Kampusi, që përfshin Universitetin dhe EPFL-në, pret 25.000 studentë, që vijnë nga Zvicra e nga gjetkë. Ka edhe shkolla të tjera që shquhen në fushën e tyre, si shkolla e arteve dhe dizenjës (ECAL), e xhazit dhe muzikës së sotme (EJMA), si edhe shkolla e baletit Rudra-Béjart.

## Dendësi e madhe kulturore

Oferta kulturore në këtë qytet është jashtëzakonisht e dendur, në raport me madhësinë e tij. Ka gati njëzetë muze, të cilët i tërheqin vizitorët në fusha të shumëllojta si historia, shkencat, artet e bukura, arti bashkëkohor, apo edhe arti bruto, me një koleksion të pasqor në botë. Lozana ka rreth 15 teatro, institucione të njohura si Teatri Vidi - Lozanë (Théâtre Vidy-Lausanne) apo skena më eksperimentale, orkestra të shumta klasike, një Opera, festivale të ndryshme dhe një sërë sallash që i kushtohen muzikës së sotme. Pa harruar lulen e baletit, Baletin Bezhar të Lozanës (Béjart Ballet Lausanne), që është themeluar nga koreografi i famshëm Moris Bezhar (Maurice Béjart).

## Ekonomi me teknologji të lartë

Lozana ka më shumë vende pune nga sa ka banorë. Ekonomia e saj, e cila u kushtohet kryesisht shërbimeve dhe diturisë, gjeneron 170.000 vende pune. Në saje sidomos të Qendrës spitalore universitare vaudeze (Centre hospitalier universitaire vaudois - CHUV), ajo ofron shërbime shëndetësore të cilësisë së lartë. Disa dhjetëra mijëra banesa të reja janë ndërtuar, duke mundësuar kështu çtendosjen e tregut të banesave.

[www.lausanne.ch](http://www.lausanne.ch)

# Lozana ju mirëpret

Më shumë se 15'000 veta vendosen çdo vit në Lozanë. Ngado që të vijmë ata, qoftë nga një komunë fqinje a një rajon tjetër i Zvicrës, apo nga një vend më i largët, Qyteti i Lozanës dëshiron t'ua lehtësojë hapat e parë në kryeqytetin vaudez.

## Seancë pritjeje nga Bashkia

Çdo vit, në nëntor, për banorët e rinj, zhvillohet një seancë pritjeje, në Kazinionë e Monbënonit (Casino de Montbenon). Me këtë rast, shërbime të shumta të Qytetit hapin aty stande, me qëllim që të informojnë pjesëmarrësit lidhur me veprimtaritë e tyre në gjirin e administratës bashkiake.

[www.lausanne.ch/accueil](http://www.lausanne.ch/accueil)

## Atelje pritjeje dhe informimi në gjuhë të ndryshme dhe vizita të administratës me udhërrëfyes

Për të familjarizuar popullsinë me temat e jetës së përditshme dhe për t'iu përgjigjur pyetjeve lidhur me punësimin, formimin, institucionet, shëndetin, strehimin dhe sistemin shkollor, organizohen falas atelje pritjeje dhe vizita të administratës me udhërrëfyes. Këto atelje propozohen në disa gjuhë: sot për sot, në frëngjisht, anglisht, spanjisht, italisht e portugalisht.

[www.lausanne.ch/welcome](http://www.lausanne.ch/welcome)

## Info Cité

Zyra Info Cité, si pikë informimi kryesore e Lozanës, informon, orienton dhe drejton lozanezët dhe vizitorët kalimtarë në përçapjet e tyre apo në realizimin e dëshirave të tyre për të mësuar e zbuluar gjëra të reja.

### Info Cité (Pikë informimi)

Place de la Palud 2, case postale 6904, 1002 Lausanne  
Tel. 021 315 25 55, [infocite@lausanne.ch](mailto:infocite@lausanne.ch)  
[www.lausanne.ch/infocite](http://www.lausanne.ch/infocite)

## Integrimi i të imigruarve

Zyra lozaneze për të imigruarit (Le Bureau lausannois pour les immigrés – BLI) ju pret dhe ju informon për temat e integrimit profesional dhe të pjesëmarrjes në jetën shoqërore e qytetare. BLI-ja është gjithashtu një vend referimi për parandalimin e racizmit; ajo mbështet njerëzit në rast situatash me karakter racist.

Zyra kantonale për integrimin e të huajve dhe parandalimin e racizmit (Le Bureau cantonal pour l'intégration des étrangers et la prévention du racisme – BCI) është organi kompetent pranë Këshillit të Shtetit në fushën e integrimit të të huajve dhe atë të parandalimit të racizmit. Zyra komunale të integrimit ka edhe në komunat e Rënanit, Iverdonit, Nionit, Vëvesë dhe Besë (Renens, Yverdon, Nyon, Vevey, Bex).

### Bureau lausannois pour les immigrés – BLI (Zyra lozaneze për të imigruarit)

Place de la Riponne 10, case postale 5032, 1002 Lausanne  
Tel. 021 315 72 45, [bli@lausanne.ch](mailto:bli@lausanne.ch), [www.lausanne.ch/bli](http://www.lausanne.ch/bli)  
Pritje: Ora 8.00-12.00, 13.00-17.00

### Bureau cantonal pour l'intégration des étrangers et la prévention du racisme – BCI (Zyra kantonale për integrimin e të huajve dhe parandalimin e racizmit)

Rue du Valentin 10, case postale, 1014 Lausanne, tel. 021 316 49 59  
[info.integration@vd.ch](mailto:info.integration@vd.ch), [www.vd.ch/integration](http://www.vd.ch/integration)

## Shoqatat e bashkësive

Të shumta janë shoqatat e migrantëve që veprojnë në Lozanë e në katonin e Vaudit dhe që mbështesin integrimin. Një listë e shoqatave lozaneze gjendet në sitin e BLI-së.

Qendra shoqërore protestante (Centre social protestant) mund të japë përgjigje për pyetjet administrative, si ato që kanë të bëjnë me lejet e qëndrimit, martesën dhe ribashkimin familjar.

### Lista e shoqatave

gjendet në adresën [www.lausanne.ch/associations-migrants](http://www.lausanne.ch/associations-migrants)

### Centre social protestant – La Fraternité (Qendra shoqërore protestante - Vëllazëria)

Place Arlaud 2, 1003 Lausanne, tel. 021 213 03 53  
[frat@csp-vd.ch](mailto:frat@csp-vd.ch), [www.csp.ch/fraternite](http://www.csp.ch/fraternite)  
Shërbim i gatshëm shoqëror: të martën dhe të enjten nga ora 18.00 deri në orën 20.00

# Mbërritja juaj: përçapjet që duhet të bëni

## Regjistrimi në komunë

Nëse dëshironi të jetoni në Lozanë, keni tetë ditë afat pas mbërritjes suaj për t'u regjistruar në regjistrin e banorëve (Contrôle des habitants). Ju duhet të paraqiteni personalisht në adresën: rue Port-Franc 18, në Flon. Duhet të paraqisni një numër dokumentesh. Njoftimin e ardhjes suaj mund ta bëni edhe paraprakisht me anën e një formulari në Internet. Nëse nuk jeni me shtetësi zvicerane dhe dëshironi të qëndroni këtu më shumë se tre muaj, është e nevojshme që të pajiseni me leje qëndrimi.

[Contrôle des habitants \(Regjistri i banorëve\)](#), [www.lausanne.ch/ch](http://www.lausanne.ch/ch), tel. 021 315 31 33

## Kontraktimi i një sigurimi

Nëse banoni në Zvicër, disa sigurime janë të detyrueshme: sigurimi bazë për sëmundjet dhe aksidentet; sigurimi për përgjegjësinë civile (PC), po qe se zotëroni një mjet, jeni pronar i një ndërtese apo nëse kjo ju kërkohet nga agjencitë e administrimit të banesave; për zjarrin dhe fatkeqësitë natyrore (ECA) për ndërtesat dhe pajisjet. Ka edhe sigurime të tjera që janë me dëshirë, si sigurimi plotësues për sëmundjet, përgjegjësinë civile, banesën, humbjen e të ardhurave, mbrojtjen juridike, si edhe sigurimi i jetës. Për më tepër informacion f.22

[www.lausanne.ch/pratique](http://www.lausanne.ch/pratique)

## Lidhja në rrjetet e ndryshme

Sapo të jeni vendosur, duhet të regjistroheni pranë furnitorit të elektricitetit, gazit, etj. (Services industriels de Lausanne - SiL). Mund të zgjidhni edhe shërbimet multimedia (televizion, Internet, telefoni) që ofron SiL-ja përmes rrjetit të saj kabllor.

Cilido që regjistrohet në regjistrin e banorëve, merr automatikisht nga shoqëria Serafe një faturë për pagimin e së drejtës për të kapur sinjalin e radios dhe televizionit. Detyrimet për kapjen e radios dhe televizionit paguhen për çdo banesë.

Services industriels (Shërbimet industriale), [www.lausanne.ch/sil](http://www.lausanne.ch/sil), tel. 0842 841 841 ose Citycable, [www.citycable.ch](http://www.citycable.ch), tel. 021 315 88 88

Serafe, [www.serafe.ch](http://www.serafe.ch), tel. 058 201 31 67 ose Office fédéral de la communication (Zyra federale e komunikacionit), [www.ofcom.admin.ch](http://www.ofcom.admin.ch)

## Regjistrimi në shkollë

Fëmijët e moshës shkollore mund të regjistrohen, që me mbërritjen e tyre e në çdo kohë të vitit, pranë Shërbimit të shkollave fillore e të shkollës së dytë (Service des écoles primaires et secondaires). Për fëmijët që nuk e zotërojnë ende frëngjishten parashikohet një mbështetje e posaçme. Për më shumë informacion f.15

## Gjetja e një zgjidhjeje për mbajtjen e fëmijës suaj

Fëmijët e moshës parashkollore mund të regjistrohen në qendra të posaçme ku ata priten e mbahen gjatë ditës. Duke qenë se kërkesa është shumë e madhe dhe vendet në këto qendra janë të kufizuara, është me rëndësi që fëmijët të regjistrohen sa më parë në listën e pritjes. Ajo që do t'ju informojë për sa sipër është Zyra e informimit të prindërve (Bureau d'information aux parents – BIP).

Qendrat e pritjes së nxënësve UAPE dhe APEMS i presin dhe i mbajnë nxënësit jashtë orarit shkollor. Për më shumë informacion f.16

## Pagimi i tatimeve

Sistemi zviceran i tatimeve përbëhet nga tre nivele: ai federal, kantonal dhe komunal. Çdo njeri që jeton në kanton, kur mbush moshën 18 vjeç, qoftë kur ka, qoftë kur nuk ka burime të ardhurash, është i detyruar të plotësojë deklaratën vjetore të tatimeve. Tatimpaguesi i ardhshëm, përfshirë edhe punonjësit e huaj, duhet të regjistrohet në Administratën kantonale të tatimeve (Administration cantonale des impôts).

Administration cantonale des impôts (Administrata kantonale e tatimeve)  
[www.vd.ch/impots](http://www.vd.ch/impots), tel. 021 316 00 00

## Regjistrimi i automjeteve

Nëse vendoseni në Zvicër dhe jeni titullar i një lejeje për drejtimin e automjeteve të huaj të vlefshme, keni një afat prej 12 muajsh, qysh nga mbërritja juaj, për ta shkëmbyer atë me një leje drejtimi zvicerane. Që të lejohen të qarkullojnë, mjetet me motor dhe rimorkiot duhet të pajisen me targa. Për më shumë informacion f.34-35

Service des automobiles et de la navigation du Canton de Vaud (Shërbimi i automjeteve dhe lundrimit i Kantonit të Vaudit), [www.vd.ch/san](http://www.vd.ch/san)  
Tel. 021 316 82 10

## Regjistrimi i qenve


Çdo qen duhet të regjistrohet nga i zoti i vet pranë Shërbimit të financave/ tatimeve (Service des finances/impôts) me telefon, përmes Internetit, apo duke u paraqitur pranë rajonit të policisë së lagjes.

Service des finances/impôts (Shërbimi i financave/tatimeve), [www.lausanne.ch/impots](http://www.lausanne.ch/impots)  
Tel. 021 315 43 11

# Vendndodhja e institucioneve bashkiake në planin e qytetit

- A** Services industriels  
(Shërbimet industriale)  
Energjia elektrike, gazi, multimedia
- B** Direction de l'enfance, de la jeunesse et des quartiers  
(Drejtoria e fëmijërisë, rinisë dhe lagjeve)  
Regjistrimi i fëmijëve në shkollë apo në qendrat e pritjes në mjedisin shkollor.  
Bureau d'information aux parents – BIP  
(Zyra e informimit të prindërve)  
Bureau lausannois pour les familles  
(Zyra lozaneze për familjet)  
  
Service du logement et des gérances  
(Shërbimi i strehimit dhe agjencive të administrimit të banesave)  
Banesat e subvencionuara  
  
Office régional de placement – ORP  
(Zyra rajonale e punësimit)
- C** Bibliothèque municipale  
(Biblioteka komunale)
- D** Service des assurances sociales  
(Shërbimi i sigurimeve shoqërore)  
Alokacione, ndihmat plotësuese (subsides),  
Sigurimi për pleqërinë dhe të mbijetuarit - AVS
- E** Contrôle des habitants  
(Regjistri i banorëve)  
Regjistrimi në bashki, ripërtëritja e lejes së qëndrimit, ndryshimi i adresës
- F** Service de la propreté urbaine  
(Shërbimi i pastrimit të qytetit)  
Kalendari i mbledhjes së mbetjeve

- G** Info Sociale  
Informacion mbi ndihmat shoqërore
- H** Bureau lausannois pour les immigrés – BLI  
(Zyra lozaneze për të imigruarit)  
Objets trouvés (Sendet e gjetura)  
Inspection du travail  
(Inspektorati i punës)
- I** Hôtel de Ville (Selia e Bashkisë)  
Info Cité
- J** SIL Citycable  
Abonime multimedia  
(televizion, Internet, telefoni)



# Shkolla dhe rinia

Në Lozanë, fëmijët dhe të rinjtë frekuentojnë qendra pritjeje, shkollimi dhe argëtimi, që përkojnë me nevojat dhe interesat e tyre.

## Sistemi shkollor

Në Zvicër, nga shkolla fillore deri në universitet, shkollimi i nxënësve është në kompetencën e kantoneve, (me përjashtim të shkollave politektike federale). Shkolla e detyrueshme fillon kur fëmija mbush moshën 4 vjeç dhe zgjat njëmbëdhjetë vjet.

Pas njëmbëdhjetë vjetësh shkollimi të detyrueshëm, nxënësit mund të bëjnë një formim profesional (në përfundim të së cilit pajisen me certifikatë federale aftësie – CFA) ose të ndjekin studimet e larta (gjimnazin ose shkollat e larta të specializuara).

### **Direction générale de l'enseignement obligatoire (Drejtoria e përgjithshme e arsimit të detyrueshëm)**

Rue de la Barre 8, 1014 Lausanne, tel. 021 316 32 32  
[www.lausanne.ch/ecole](http://www.lausanne.ch/ecole), [www.vd.ch/scolarité](http://www.vd.ch/scolarité) ku mund të ngarkoni dokumente të përkthyer në gjuhë të ndryshme.

## Regjistrimi i fëmijëve në shkollë bëhet qysh nga moshë 4 vjeçare

Në Lozanë ka pesëmbëdhjetë shkolla, të cilat janë të shpërndara në tërë qytetin. Regjistrimet janë të përqendruara dhe bëhen vetëm pranë Shërbimit të shkollave fillore e të shkollës së dytë (shkolla njëmbëdhjetë vjeçare) (Service des écoles primaires et secondaires). Ka edhe shumë shkolla private, që përdorin metoda pedagogjike alternative ose që janë shumëgjuhëshe.

### **Service des écoles primaires et secondaires (Shërbimi i shkollave fillore e të shkollës së dytë)**

Place Chauderon 9, case postale 5032, 1002 Lausanne, tel. 021 315 64 11  
[seps@lausanne.ch](mailto:seps@lausanne.ch), [www.lausanne.ch/seps](http://www.lausanne.ch/seps)

### **Association vaudoise des écoles privées (Shoqata vaudeze e shkollave private)**

Route du Lac 2, 1094 Paudex, case postale 1215, 1001 Lausanne  
Tel. 058 796 33 00, [info@avdep.ch](mailto:info@avdep.ch), [www.avdep.ch](http://www.avdep.ch)

## Nxënësit jo frëngjishtfolës 4-15 vjeç

Fëmijët nga 4 deri në 15 vjeç, që mbërrijnë në Lozanë dhe që nuk e zotërojnë mjaftueshëm gjuhën frënge, orientohen drejt Qendrës së burimeve për fëmijët që flasin gjuhë të tjera (Centre de ressources pour élèves allophones – CREAL). Pas një bisede, fëmija mund të futet në një klasë pritjeje ose të ndjekë kurse intensive të frëngjishtes që synojnë ta lehtësojnë futjen e tij në shkollën e rregullt.

### **Centre de ressources pour élèves allophones de Lausanne – CREAL (Qendra e burimeve për fëmijët që flasin gjuhë të tjera)**

Avenue d'Echallens 1, 1004 Lausanne, tel. 021 315 64 86, [www.lausanne.ch/creal](http://www.lausanne.ch/creal)

## Nxënësit jo frëngjishtfolës 15-20 vjeç

Të rinjtë e të rejt nga 15 deri 20 vjeç që kanë mbërritur në Zvicër rishtazi, nëse ka vende të lira, mund të futen për një vit shkollor në Shkollën e tranzicionit (École de la transition). Kjo u krijon këtyre nxënësve mundësinë për t'u familiarizuar me shoqërinë pritëse, ua lehtëson integrimin dhe, pas një kohe, hyrjen në një formim profesional fillestar apo në studimet akademike. Regjistrimi bëhet përmes Portalit Migration (Portail Migration) të Zyrës kantonale të orientimit shkollor e profesional (Office cantonal d'orientation scolaire et professionnelle – OCOSP).

### **Portail Migration – OCOSP (Portali Migration)**

Rue de la Borde 3d, 1014 Lausanne, tel. 021 316 11 40  
[www.vd.ch/themes/formation/orientation/trouver-une-formationprofession-lorsquon-vient-darriver-dans-le-canton-de-vaud](http://www.vd.ch/themes/formation/orientation/trouver-une-formationprofession-lorsquon-vient-darriver-dans-le-canton-de-vaud)



## Qendrat e pritjes parashkollore

Qendrat e jetës foshnjore (centre de vie infantine), çerdhet, qendrat komunale dhe private të pritjes dhe mbajtjes së fëmijëve të subvencionuara (garderies), vendet e lojërave (halte-jeux) dhe kopshtet e fëmijëve bëjnë pjesë në Rrjetin e pritjes ditore të Lozanës, të njohur si Rrjeti-L (Réseau d'accueil de jour de Lausanne, le Réseau-L). Këto qendra propozojnë një pritje, qoftë me kohë të plotë, me qëllim që jeta profesionale e prindërve të pajtohet me atë familjare, qoftë me kohë të kufizuar, me qëllim që fëmijët të hyjnë në shoqëri me fëmijë të tjerë. Zyra e informimit të prindërve (BIP) i informon prindërit, i orienton dhe i regjistron kërkesat e tyre në Listën e pritjes së përqendruar (LAC) të Rrjetit-L.

Në rast nevoje, nxënësit e klasave 1P e 2P, mund të pranohen në qendrat e pritjes së nxënësve në shkollë (Unité d'accueil pour écoliers – UAPE).

Qendrat e pritjes së fëmijëve në shkollë (Accueil pour enfants en milieu scolaire - APEMS) u sigurojnë fëmijëve të klasave 3P deri në 6P një vend qëndrimi me kujdestari, nga ora 7.00 deri në orën 18.30, në rast se prindërit e tyre ushtrojnë veprimtari profesionale.

### **Bureau d'information aux parents – BIP (Zyra e informimit të prindërve)**

Place Chauderon 9, case postale 5032, 1002 Lausanne  
Pritja e hapur çdo ditë ora 8.30-11.30 dhe 13.30-16.30  
Shërbim i gatshëm telefonik: 021 315 60 00 e martë,  
e enjte dhe e premte ora 10.00-12.00  
bip@lausanne.ch, www.lausanne.ch/bip

### **Qendrat e ndryshme të pritjes së fëmijëve në Lozanë**

[www.lausanne.ch/structures-accueil](http://www.lausanne.ch/structures-accueil)

### **Service d'accueil de jour de l'enfance (Shërbimi i pritjes ditore të fëmijëve)**

Place Chauderon 9, case postale 5032, 1002 Lausanne, tel. 021 315 68 33/08  
apems@lausanne.ch, www.lausanne.ch/apems

## Kurset e gjuhës dhe kulturës së origjinës

Përvetësimi i gjuhës amtare, përmes kurseve të gjuhës dhe kulturës së origjinës, e nxit ndërtimin e identitetit shumëkulturore të fëmijës. Njohja e mirë e gjuhës amtare është shpesh një bazë e rëndësishme për mësimin e gjuhës së vendit pritës. Lista e kurseve të gjuhës dhe kulturës së origjinës, që propozojnë shoqatat lozaneze, gjendet në broshurën *Apprendre à Lausanne* të botuar nga BLL-ja.

### **Bureau lausannois pour les immigrés – BLI (Zyra lozaneze për të imigruarit)**

Lista e kurseve në [www.lausanne.ch/apal](http://www.lausanne.ch/apal)

## Veprimtari të gjatë pushimeve

Gjatë pushimeve shkollore, fëmijëve u propozohen veprimtari të ndryshme argëtuese. Qendra e pritjes gjatë pushimeve (Le Domaine d'accueil vacances) qëndron në dispozicion të familjeve, për t'i orientuar ato dhe për të lehtësuar veprimet e regjistrimit.

### **Direction de l'enfance, de la jeunesse et des quartiers – Domaine accueil vacances (Drejtoria e fëmijërisë, rinisë dhe lagjeve – Qendra e pritjes gjatë pushimeve)**

Place Chauderon 7a, case postale 5032, 1002 Lausanne, tel. 021 315 68 22/65  
jeunessevaccances@lausanne.ch, www.lausanne.ch/jeunessevaccances

### **DATAT E PUSHIMEVE SHKOLLORE:**

[www.lausanne.ch/vacances](http://www.lausanne.ch/vacances)

# Studimet dhe formimi

Në Lozanë ndodhen qendra të shumta të formimit të specializuar: Universiteti (UNIL), Shkolla politeknike federale e Lozanës (EPFL), shkollat e larta të specializuara, shkollat profesionale të larta (për hoteleri, administrim ndërmarrjeje, artet plastike,...), si dhe shkolla të shumta private.

## Orientimi shkollor e profesional

Qendra rajonale e orientimit shkollor dhe profesional (Centre régional d'orientation scolaire et professionnelle - OSP) u jep nxënësve në mbarim të shkollimit të detyrueshëm, të rinjve në formim apo në tranzicion, si dhe të rriturve, informacione dhe këshilla për çdo çështje që ka të bëjë me formimin.

Në Qendrën e informimit mbi studimet dhe profesionet, mund të bëhen takime të shkurtra informuese, falas dhe të hapura për këdo, çdo pasdite (e hënë-e enjte nga ora 13.30 deri në orën 17.00 dhe të premten nga ora 12.00 deri në orën 16.00). Gjatë këtij takimi të parë, mund të caktohet një takim i dytë për një këshillim individual.

Për të rinjtë e moshës 15-25 vjeç, të cilët sapo kanë mbërritur në Kantonin e Vaudit dhe që nuk flasin aspak apo flasin pak frëngjisht dhe që janë të interesuar për të ndjekur një formim, propozohet një takim pritjeje përmes Portalit Migration (Portail Migration). (f. 15)

Seanca informimi (për mundësitë e formimit, bursat, etj.) organizohen rregullisht, pa regjistrim. Një shërbim i gatshëm për rileximin e CV-ve punon çdo të premte, nga ora 12.00 deri në orën 16.00.

**Centre régional d'orientation scolaire et professionnelle Lausanne – OSP**  
(Qendra rajonale e orientimit shkollor e profesional Lozanë)  
Rue de la Borde 3d, 1014 Lausanne, tel. 021 316 11 20, [www.vd.ch/orientation](http://www.vd.ch/orientation)

**Guichet d'information de la Direction générale de l'enseignement postobligatoire – DGEP**  
(Sportel informimi i Drejtorisë së përgjithshme të arsimit të mesëm)  
Rue Saint-Martin 26, 1014 Lausanne, tel. 021 316 63 04  
[info.dgep@vd.ch](mailto:info.dgep@vd.ch), [www.vd.ch/dgep](http://www.vd.ch/dgep)

## Ndihmat për formim

Kantoni i Vaudit mund të japë bursa studimi, sipas gjendjes financiare të studentit dhe me këkesë të këtij të fundit. Fondacioni lozanez i ndihmës përmes punës (Fondation lausannoise d'aide par le travail - F.L.A.T.) ka për qëllim të lehtësojë integrimin profesional, duke financuar një formim apo duke mbuluar shpenzimet që lidhen me ushtrimin e një profesioni. Ai është i hapur për ata që e kanë banesën kryesore në territorin e komunës së Lozanës dhe që kanë leje qëndrimi të vlefshme dhe jo të përkohshme. Mbështetja nga Fondacioni ka karakter ndihmës; ajo nuk merr parasysh borxhet dhe kërkesat për ndihmë me efekt prapaveprues.

Informacione lidhur me formimin do të gjeni në sitin [www.vd.ch/orientation](http://www.vd.ch/orientation) dhe për bursat e studimit në [www.vd.ch/ocbe](http://www.vd.ch/ocbe)

**Fondation lausannoise d'aide par le travail – F.L.A.T.**  
(Fondacioni lozanez i ndihmës përmes punës)

Sévelin 8, case postale 5032, 1002 Lausanne, tel. 021 315 71 28  
[flat@lausanne.ch](mailto:flat@lausanne.ch), [www.lausanne.ch/flat](http://www.lausanne.ch/flat)

## Njohja e diplomave

Për çështjet e përgjithshme që lidhen me njohjen e diplomave të huaja, bashkëbiseduesi kryesor është Pika e kontaktit kombëtar (Point de contact national) në Sekretariatit e Shtetit për formimin, kërkimet dhe inovacionin.

**Point de contact national pour la reconnaissance des diplômes**  
(Pika e kontaktit kombëtar për njohjen e diplomave).

Hotline 058 462 28 26, nga e hëna deri të premten nga ora 9.30 deri në 11.30 si dhe të martën e të mërkurën nga ora 14.00 deri në orën 16.00. Jashtë këtij orari, mund të shkruani në [pointdecontact@sbfi.admin.ch](mailto:pointdecontact@sbfi.admin.ch)  
Informacione të përgjithshme: [www.sbfi.admin.ch](http://www.sbfi.admin.ch)

## Kurset e frëngjishtes

Zotërimi i gjuhës së vendit pritës luan rol të rëndësishëm në procesin e integritit, e pikërisht mundëson përfitimin prej shërbimeve në fushën e punës, shëndetit dhe formimit. Një listë e kurseve të frëngjishtes, që propozohen nga shoqatat dhe shkollat private, gjendet në sitin e Internetit të Zyrës lozaneze për të imigruarit (BLI) dhe në broshurën *Apprendre à Lausanne*.

**Bureau lausannoise pour les immigrés – BLI (Zyra lozaneze për të imigruarit)**  
Place de la Riponne 10, case postale 5032, 1002 Lausanne, tel. 021 315 72 45  
[bli@lausanne.ch](mailto:bli@lausanne.ch), [www.lausanne.ch/bli](http://www.lausanne.ch/bli) ou [www.lausanne.ch/apal](http://www.lausanne.ch/apal)

# Puna

Jeni në kërkim të një pune? Ju mund t'u përgjigjeni ofertave të punës që bëhen në shtyp apo në Internet; po ashtu mund të regjistroheni në Zyrën rajonale të punësimit (Office régional de placement) (shërbime falas) apo në agjenci punësimi private. Mos ngurroni të vizitoni sitet e Internetit të ndërmarrjeve e shoqërive që ju interesojnë dhe t'u dërgoni atyre kërkesa për punë, edhe pa pasur oferta prej tyre.

## Puna juaj e parë në Zvicër

Për gjetjen e një pune, rol të rëndësishëm luan edhe rrjeti i të njohurve. Në këtë drejtim, pjesëmarrja juaj në veprimtaritë e ndonjë shoqate mund të jetë e dobishme, pasi kështu rriten njohuritë tuaja për tregun e punës.

Të huajt duhet të pajisen me leje pune. Kërkesën për leje pune për ju mund ta bëjë edhe punëdhënësi, nëse ju i plotësoni kushtet për marrjen e saj.

Për t'ju ndihmuar në kërkimin e një pune, Zyra lozaneze për të imigruarit vë në dispozicionin tuaj një shërbim të gatshëm pritjeje, në spanjisht, portugalisht, italisht, anglisht e frëngjisht.

**Bureau lausannois pour les immigrés – BLI (Zyra lozaneze për të imigruarit)**

Place de la Riponne 10, tel. 021 315 72 45 ou [www.lausanne.ch/pef](http://www.lausanne.ch/pef)

## Punësimi dhe orientimi

Njerëzit që janë të papunë, që kanë kërkuar vetë largimin nga puna, apo që kanë marrë nga punëdhënësi letrën e pushimit nga puna, brenda një afati të shkurtër, mund të regjistrohen në Zyrën rajonale të punësimit (Office régional de placement – ORP). Ata duhet detyrimisht të jenë banorë të Lozanës dhe të figurojnë në Regjistrin e banorëve. Të huajt duhet të jenë të pajisur si me leje qëndrimi edhe me leje pune. Këshilltarët e ORP-së e kanë për detyrë që t'i orientojnë njerëzit në kërkimin e punës dhe të lehtësojnë përçapjet e tyre në drejtim të integritit profesional.

Në rast se humbisni vendin e punës, për të përfituar nga pagesat e papunësisë (indemnités de chômage), duhet që të keni paguar kontributet të paktën 12 muaj, gjatë dy viteve që i paraprijnë regjistrimit tuaj në ORP.

Nëse nuk i plotësoni këto kushte, por jeni në kërkim të një pune, mund të përfitoni megjithatë nga disa shërbime që lehtësojnë integrimin tuaj profesional.

**Service du travail – Office régional de placement – ORP (Shërbimi i punës - Zyra rajonale e punësimit)**

Place Chauderon 9, case postale 5032, 1002 Lausanne, tel. 021 315 78 99  
[orp@lausanne.ch](mailto:orp@lausanne.ch), [www.lausanne.ch/orp](http://www.lausanne.ch/orp)

**Service cantonal de l'emploi (Shërbimi kantonal i punës)**

Rue Caroline 11, 1014 Lausanne, tel. 021 316 61 04  
[info.sde@vd.ch](mailto:info.sde@vd.ch), [www.vd.ch/sde](http://www.vd.ch/sde)

Qyteti i Lozanës i vendos ofertat e veta në linjë në [www.lausanne.ch/emploi](http://www.lausanne.ch/emploi)

## E drejta e punës

Kushtetuta zvicerane nuk parashikon një rrogë minimale. Por, në disa degë të ekonomisë, rroga minimale mujore dhe/ose për orë përcaktohet me anën e konventave kolektive. Për të njohur hollësitë ligjore që kanë të bëjnë me kontratën tuaj të punës, ju mund të kërkonin ndihmë nga shërbimi kujdestar i Inspektoratit të punës të Lozanës (Inspection du travail Lausanne). Administrata federale ka një program llogaritës të rrogave për qëllime statistikore, i cili gjendet në sitin [www.lohnrechner.bfs.admin.ch](http://www.lohnrechner.bfs.admin.ch)

**Service du travail – Inspection du travail Lausanne (Shërbimi i punës - Inspektorati i punës Lozanë)**

Place de la Riponne 10, case postale 5032, 1002 Lausanne, tel. 021 315 76 80  
[itl@lausanne.ch](mailto:itl@lausanne.ch), [www.lausanne.ch/inspectiondutravail](http://www.lausanne.ch/inspectiondutravail)

# Shëndeti dhe ndihma shoqërore

Mos harroni të bëni sigurimin shëndetësor të detyrueshëm, brenda tre muajve, pas mbërritjes suaj! Rrjeti i përkujdesjeve shëndetësore dhe i ndihmës shoqërore mund t'ju shoqërojë në trajtimin e problemeve të jetës së përditshme.

## Sigurimi për sëmundjet dhe aksidentet

Përveç sigurimeve shoqërore, shumat e kuotave mujore të së cilave zbriten drejtpërdrejt nga rroga (arka e pensionit, sigurimi për papunësinë, sigurimi për pleqërinë dhe invaliditetin), sigurimi për sëmundjet e aksidentet është i detyrueshëm për këdo që banon në Zvicër. Në parim, nëse jeni i punësuar, për aksidentet siguroheni automatikisht nga punëdhënësi juaj. Nëse nuk ushtroni veprimtari profesionale si rrogëtar, edhe për aksidentet duhet të siguroheni vetë pranë një sigurimi shëndetësor.

Duke qenë se zgjedhja e sigurimit shëndetësor është e lirë për secilin, Zyra federale e shëndetit publik (Office fédéral de la santé publique - OFSP) bën krahasimin e kuotave mujore (primes) të të gjitha sigurimeve shëndetësore dhe e paraqet atë në sitin [www.priminfo.ch](http://www.priminfo.ch).

Në varësi të të ardhurave tuaja, Zyra vaudeze e sigurimit shëndetësor (Office vaudois de l'assurance-maladie - OVAM) mund t'ju japë ndihma plotësuese (subsides) për pagesën e kuotave mujore të sigurimit shëndetësor të detyrueshëm. Kërkesa për ndihmë plotësuese duhet të dorëzohet pranë Agjencisë së sigurimeve shoqërore ose në sitin e OVAM-së.

## Ndihmat plotësuese (subsides) për sigurimin shëndetësor

### Service des assurances sociales (Shërbimi i sigurimeve shoqërore)

Place Chauderon 7, case postale 5032, 1002 Lausanne, tel. 021 315 11 11  
[sas@lausanne.ch](mailto:sas@lausanne.ch), [www.lausanne.ch/assurances\\_sociales](http://www.lausanne.ch/assurances_sociales)

### Office vaudois de l'assurance-maladie (Zyra vaudeze e sigurimit shëndetësor)

Chemin de Mornex 40, 1014 Lausanne, tel. 021 557 47 47 e hënë,  
e mërkurë e premte: Ora 8.00-11.45  
[www.vd.ch/subside-assurance-maladie](http://www.vd.ch/subside-assurance-maladie)

## Zgjedhja e mjekut

Në Zvicër, në përgjithësi, njerëzit kanë një « mjek familjeje », i cili ndjek dosjen e tyre dhe, po qe nevoja, i drejton ata te një specialist apo në urgjencë. Ka mjekë që flasin shumë gjuhë: për këtë mund të informoheni pranë Shoqërisë vaudeze të mjekësisë (Société vaudoise de médecine) ose në sitin e Federatës së mjekëve (Fédération des médecins).

### Société vaudoise de médecine (Shoqëria vaudeze e mjekësisë)

(lista e mjekëve që flasin disa gjuhë)

Chemin de Mornex 38, case postale 7443, 1002 Lausanne, tel. 021 651 05 05  
[info@svmed.ch](mailto:info@svmed.ch), [www.svmed.ch](http://www.svmed.ch) ou sur le site national [www.doctorfmh.ch](http://www.doctorfmh.ch)

## Ndihma e parë / urgjencat

Mjekët e përgjithshëm të Poliklinikës mjekësore universitare (Policlinique médicale universitaire – PMU), ashtu si edhe mjekët e pavarur, bëjnë një ndjekje mjekësore të personalizuar e afatgjatë të pacientëve të tyre. PMU-ja ka një shërbim të ndihmës shoqërore dhe një barnatore publike. Qendra spitalore universitare vaudeze (Centre hospitalier universitaire vaudois – CHUV) garanton edhe përkujdesjet urgjente, në rast nevojë. Rastet urgjente pediatrike merren përsipër nga Spitali i fëmijëve (Hôpital de l'enfance).

Fondacioni Point d'eau (Pikë uji) u ofron njerëzve në nevojë shërbime falas e me çmim të ulët, në fushën e higjienës e të shëndetit: dushe, makina rrobolarëse, si dhe përkujdesje dentare dhe mjekësore (mjekë, infermierë, specialistë për kockat (osteopatë), për këmbët (podologë) e masazherë.

### Policlinique médicale universitaire – PMU (Poliklinika mjekësore universitare)

Rue du Bugnon 44, 1011 Lausanne, tel. 021 314 60 60, çdo ditë 24 orë në 24  
Voie du Chariot 4 (Flon), 1003 Lausanne, tel. 021 314 90 90 e hënë - e shtunë  
ora 7.00-21.00, të dielën dhe ditët e pushimit ora 9.00-19.00

### Centre hospitalier universitaire vaudois – CHUV

#### (Qendra spitalore universitare vaudeze)

Rue du Bugnon 21, 1011 Lausanne, tel. 021 314 11 11, [www.chuv.ch](http://www.chuv.ch)

### Hôpital de l'enfance (Spitali i fëmijëve)

Chemin de Montétan 16, 1007 Lausanne, tel. 021 314 84 84 (urgjenca 24 orë në 24)  
[www.hopital-enfance.ch](http://www.hopital-enfance.ch)

### Point d'eau (Pikë uji)

Avenue de Morges 26, 1004 Lausanne, të hënë dhe të enjten:  
Ora 14.00-20.00 e martë, e mërkurë, e premte: Ora 10.00-16.00  
Tel. 021 626 26 44, [info@pointdeau-lausanne.ch](mailto:info@pointdeau-lausanne.ch), [www.pointdeau-lausanne.ch](http://www.pointdeau-lausanne.ch)

## URGJENCAT NË RAST RREZIKU PËR JETËN

Në rast urgjence, thërrisni: tel. 144 (24 orë në 24)

Mjek roje: tel. 0848 133 133 (24 orë në 24)

## Shëndeti dhe migrimi

Shoqata Appartenances ofron konsulta terapeutike në rast traumash që lidhen me migrimin. Nëse keni nevojë për përkthyes, drejtohuni te shërbimi Intermedia i shoqatës Appartenances, që ofron ndihmë më shumë se pesëdhjetë gjuhë.

### Appartenances / Shërbimi Intermedia

Rue des Terreaux 10, 1003 Lausanne, tel. 021 341 12 50  
interpretariat@appartenances.ch, www.appartenances.ch

## Barnatoret

Barnatoret japin barna, me apo pa recetë, si dhe këshilla shëndetësore bazë. Për rastet urgjente, një barnatore qëndron roje; ajo është e hapur edhe jashtë orarit të punës, gjatë shtatë ditëve të javës, deri në mesnatë. Natën, duhet të thërrisni mjekun roje, në tel. 0848 133 133 (thirrje me tarifë normale).

## Planifikimi familjar

Fondacioni Profa (Fondation Profa) mund t'u përgjigjet gjithë pyetjeve tuaja lidhur me kontrceptimin, shtatzëninë dhe parandalimin e SIDA-s dhe gjithashtu t'ju ofrojë këshillime bashkëshortore.

### Fondation Profa (Fondacioni Profa)

Avenue Georgette 1, 1003 Lausanne, tel. 021 631 01 42  
Migrimi dhe jeta intime: tel. 021 631 01 75, www.profa.ch

## Të moshuarit / Njerëzit me aftësi të kufizuara

Lozana ofron shërbime të shumta shoqërore, shëndetësore dhe mjeko-shoqërore. Një listë e shërbimeve zyrtare e private gjendet në linjë.

### Service des assurances sociales (Shërbimi i sigurimeve shoqërore)

Place Chauderon 7, case postale 5032, 1002 Lausanne, tel. 021 315 11 11  
sas@lausanne.ch, www.lausanne.ch/aineshandicapes

## Dhuna

Qendra e këshillimit LAVI (Centre de consultation LAVI) është në dispozicion të grave dhe burrave që pësojnë akte dhune ndaj tërësisë së tyre fizike, seksuale apo psikike. Shërbimet e saj janë falas.

Qendra e pritjes Male-Preri (Centre d'accueil Malley-Prairie) është një qendër këshillimi dhe strehimi për gratë që kanë pësuar dhunë fizike a psikologjike dhe për fëmijët e tyre. Këshillimet janë falas.

Qendra e Parandalimit e Ale-së (Centre Prévention de l'Ale) i jep ndihmë dhe mbështetje kujtdo që ushtron dhunë brenda çiftit apo në gjirin e familjes. Ajo është e hapur edhe për çiftet e së njëjtës gjini.

### Centre LAVI (Qendra LAVI)

Rue du Grand-Pont 2bis, 1003 Lausanne, tel. 021 631 03 00 (24 orë në 24)

### Centre d'accueil Malley-Prairie (Qendra e pritjes Male-Preri) (24 orë në 24)

Chemin de la Prairie 34, 1007 Lausanne, tel. 021 620 76 76  
Tel. i urgjencës: natën dhe në fundjavë, 021 620 76 70  
info@malleyprairie.ch, www.malleyprairie.ch

### Centre de prévention de l'Ale (Qendra e parandalimit e Ale-së)

Rue de l'Ale 30, 1003 Lausanne, tel. 021 321 24 00  
www.prevention-ale.ch. Informacione merren me telefon ose pranë shërbimit të gatshëm, të mërkurën ora 16.00-19.00

## Shërbimi shoqëror

Shërbimi shoqëror i Lozanës (Service social Lausanne – SSL) jep ndihmë financiare dhe mbështetje shoqërore, duke respektuar dinjitetin dhe të drejtat e atyre që përfitojnë nga këto ndihma. Në sitin e tyre të Internetit, ju do të gjeni të gjitha shërbimet shoqërore të paraqitura sipas fushave dhe institucioneve që i ofrojnë ato.

### Service social Lausanne – Info sociale

#### (Shërbimi shoqëror Lozanë – Informacion shoqëror)

Place Chauderon 4, case postale 5032, 1002 Lausanne, tel. 021 315 75 11  
ssl@lausanne.ch, www.lausanne.ch/ssl

## Buxheti dhe problemet financiare

Shërbimi i gatshëm telefonik "Parlons Cash" jep këshilla mbi administrimin e buxhetit familjar dhe u përgjigjet pyetjeve në lidhje me borxhet.

Tel. 0840 4321 00 (bisedë me tarifë normale) nga e hëna deri të enjten, midis orës 8.30 dhe 13.00

# Banesat dhe mbetjet

Në Zvicër, shumica e popullsisë e merr me qira banesën e vet, përmes agjencive të administrimit të banesave (gérances). Për të gjetur një banesë, gjëja më e zakonshme është pra të kaloni përmes zyrave të këtyre agjencive.

Nga 71.000 banesat që ndodhen në territorin lozanez, më shumë se 7.000 prej tyre janë të subvencionuara. Dhënia me qira e banesave të subvencionuara u nënshtrohet disa kushteve. Qyteti i Lozanës është i ngarkuar me kontrollin e këtyre subvencioneve, të cilat ndryshojnë në funksion të gjendjes së qiramarrësve (të ardhurat, përbërja familjare, vitet e banimit në komunë, etj.).

Për njohjen e kriterëve që duhet të përmbushen për marrjen e një banese të subvencionuar, duhet t'i drejtoheni Shërbimit të strehimit dhe agjencive të administrimit të banesave (Service du logement et des gérances).

## **Service du logement et des gérances (Shërbimi i strehimit dhe agjencive të administrimit të banesave)**

Place Chauderon 9, case postale 5032, 1002 Lausanne, tel. 021 315 74 11  
slg@lausanne.ch, www.lausanne.ch/slg

## **I ♥ MES VOISINS (I ♥ FQINJËT E MI) : UDHËRRËFYES PËR FQINJËSINË E MIRË**

Broshurë e fletëpalosje në shumë gjuhë të botuara nga Zyra lozaneze për të imigruarit (BLI), në bashkëpunim me Shërbimin e strehimit dhe agjencive të administrimit të banesave.

Objekti? Sjellja në kujtesë e disa rregullave të thjeshta që synojnë promovimin e bashkëjetesës dhe fqinjësisë së mirë dhe dhënia e këshillave për zgjidhjen e konflikteve dhe trajtimin e rasteve të diskriminimit.

Për më shumë informacione: [www.lausanne.ch/bli](http://www.lausanne.ch/bli) > publications (botime)  
Këto botime mund t'i merrni falas në BLI dhe Info Cité.

## **Një refleks: seleksionimi dhe vlerësimi i mbetjeve**

Mbetjet shtëpiake duhet të futen në thasë plastike të bardhë, për të cilët parapaguhet një taksë, e të hidhen në vendin e caktuar. Këta thasë mund t'i blini në supermarket ose në Postë (La Poste). Qyteti zbret nga fatura e elektricitetit një kompensim vjetor prej 80 frangash për çdo banor. Në rast lindjeje dhe problemi të mospërmbajtjes, mund të merrni thasë falas në Shërbimin e sigurimeve shoqërore.

Për qelqin, letrën e kartonin, si dhe për mbetjet organike të çdo lloji, në ndërtesa, vihen në dispozicion kontejnerë, sa herë që një gjë e tillë është e mundur. Mbetjet voluminoze apo ndotëse, duhet t'i çoni në vende të posaçme ku ato përzgjidhen. Këto vende si dhe orari i tyre jepen me saktësi në Kalendarin e heqjes së mbetjeve (Calendrier des ramassages), i cili u shpërndahet tërë familjeve e mund të shkarkohet në sitin e Internetit të Qytetit.

## **Service de la propreté urbaine (Shërbimi i pastrimit qytetës)**

Rue des Terreaux 33, case postale 5032, 1002 Lausanne, tel. 021 315 79 11  
proprete.urbaine@lausanne.ch, www.lausanne.ch/proprete-urbaine

## **Info-déchets (Info-mbetjet)**

Tel. 0800 804 806 (numër falas)

# Jeta në lagje

Nga lagjia “Sous-gare” deri te lagjet “Bellevaux” e “Blécherette”, Lozana ka një mozaik prej katërmbëdhjetë lagjesh të ndryshme. Secila prej tyre paraqet një personalitet të vetin.

## Veprimtaritë shoqërore e kulturore

Në bashkëpunim me shoqatat e lagjeve, Fondacioni lozanez për promovimin shoqëror e kulturor (La Fondation pour l'animation socioculturelle lausannoise – FASL), administron pesë qendrat kulturore të lagjeve (Maisons de quartier), dhjetë Qendrat shoqërore e kulturore dhe dy vende të hapura për pritjen e fëmijëve në natyrë (Terrains d'aventure) që ndodhen në lagjet e Lozanës. Këto vende takimi organizojnë veprimtari nga më të ndryshmet e për të gjitha moshat, me qëllim që të nxisin kontaktet dhe të forcojnë lidhjet shoqërore.

**Fondation pour l'animation socioculturelle lausannoise – FASL**  
(Fondacioni lozanez për promovimin shoqëror e kulturor)

Chemin de Malley 28, 1007 Lausanne, tel. 021 626 43 70, info@fasl.ch, www.fasl.ch

## Festa e fqinjëve

Çdo vit, të premten e fundit të muajit maj, zhvillohet Festa e fqinjëve (La Fête des voisins). Kjo festë e fqinjëve, e njohur tashmë në shumë qytete të Evropës, vë në jetë nisma të shumta që synojnë njohjen më të mirë midis fqinjëve në lagjet e ndryshme. Edhe pse organizimi i festës me rrugë e lagje varet nga nismat individuale të banorëve, edhe Qyteti jep mbështetje e këshilla shumë të dobishme.

**Service du logement et des gérances**  
(Shërbimi i strehimit dhe agjencive të administrimit të banesave)

Place Chauderon 7, case postale 5032, 1002 Lausanne, tel. 021 315 74 74  
lafetedesvoisins@lausanne.ch, www.lausanne.ch/lafetedesvoisins

## Kontratat e lagjeve

Një kontratë lagjeje është një marrëveshje mirëbesimi midis Qytetit të Lozanës dhe njerëzve që banojnë dhe/ose punojnë në lagje, për të menduar dhe për të marrë pjesë së bashku në përmirësimin e cilësisë dhe të kuadrit të jetës në lagje, duke mbajtur parasysh interesat e tashme e të ardhme. Pas lagjeve Montelly (2010-12) e Boveresses (2013-16), tani i takon lagjes Prélaz/Valency (2016-19) që të përfundojë një kontratë të tillë. Më 2020, do të shpallet një kontratë lagjeje e re.

Më shumë hollësi për grupet e punës dhe projektet:  
[www.lausanne.ch/contrats-de-quartier](http://www.lausanne.ch/contrats-de-quartier)

## Buxheti për projektet e propozuara nga qytetarët (Budget participatif)

Buxheti për projektet e propozuar nga qytetarët (Budget participatif) nxit pjesëmarrjen e qytetarëve, duke financuar projektet e lagjes të hartuara prej tyre.

Ai u mundëson lozanezëve pjesëmarrjen në organizimin e qytetit e të lagjes së tyre, duke bërë të mundur realizimin e projekteve që ata i zgjedhin e i hartojnë vetë. Me anën e këtij buxheti, Bashkia i forcon më tej marrëdhëniet me banorët, duke shtruar për diskutim me ta përdorimin e një pjese të burimeve financiare të saj. Së fundi, ai bën të mundur që Qyteti të nxisë zhvillimin, gjallërimin dhe transformimin e lagjeve, në saje të ideve të njerëzve që banojnë në to e që u japin jetë atyre.

Për më shumë informacione shkoni në sitin [my.lausanne.ch/budget-participatif](http://my.lausanne.ch/budget-participatif)

# Shtetësia dhe të drejtat politike

Të vendosesh në Lozanë do të thotë gjithashtu të përfshihesh në mënyrë konkrete në jetën e shoqërisë duke marrë pjesë në veprimtaritë politike.

## Votimi në Lozanë. E drejta e votës dhe zgjedhjes

Popullsia thërritet në mënyrë të shpeshtë në kutitë e votimit, për të votuar për çështje të ndryshme ose për të zgjedhur përfaqësuesit e vet. Për çdo votim apo zgjedhje në nivel komunal, kantonial a federal, qytetarët zviceranë e marrin drejtpërdrejt me postë materialin e votimit.

Në sajë të Kushtetutës së re vaudeze, atë të vitit 2003, edhe të huajt që i kanë mbushur 18 vjet gëzojnë të drejtën e votës në nivel komunal, por me disa kushte si më poshtë: të kenë leje qëndrimi prej të paktën dhjetë vjetësh, të jenë banorë të kantonit të Vaudit prej të paktën tre vjetësh dhe të kenë leje qëndrimi B ose C. Materiali i votimit, për çdo votim a zgjedhje në nivel komunal, u dërgohet atyre automatikisht me postë.

Të huajt që i plotësojnë këto kritere kanë edhe të drejtën për të vënë kandidaturën e tyre për në Këshillin bashkiak apo në Bashki, në rast zgjedhjes. Duke pasur të drejtën e votës e të zgjedhjes, ata mund të nënshkruajnë edhe nisma apo referendume në nivel komunal.

Së fundi, cilido, qoftë zviceran apo i huaj, i mitur apo i rritur, mund të nënshkruajë peticione.

### Bureau du registre civique (Zyra e regjistrimit zgjedhor)

Place de la Palud 2, case postale 6904, 1002 Lausanne, tel. 021 315 22 33  
votations@lausanne.ch, www.lausanne.ch/votations,  
e hënë - e premte ora 9.30-11.00, 14.00-16.00

## Partitë politike

Partitë politike kanë për funksion të përfaqësojnë interesat e popullsisë apo të njerëzve që ndajnë të njëjtat pikëpamje me to dhe të përcjellin kërkesat e popullit deri në qendrat e vendimmarrjes politike, siç është Këshilli bashkiak.

Këshilli komunal dhe përbërja e grupeve politike lozaneze  
[www.lausanne.ch/conseil-communal](http://www.lausanne.ch/conseil-communal)

## Marrja e shtetësisë

Nëse dëshironi të merrni shtetësinë zvicerane, informohuni pranë Sektorit të natyralizimeve të Shërbimit të popullsisë të Kantonit të Vaudit (Secteur des naturalisations du Service de la population du Canton de Vaud).

Për kurse të frëngjishtes e shërbime të tjera në lidhje me kërkesën për marrjen e shtetësisë (naturalisation), konsultoni faqen e Internetit [www.lausanne.ch/bli](http://www.lausanne.ch/bli) > Citoyenneté (Shtetësia) ose broshurën *Apprendre à Lausanne*, [www.lausanne.ch/apal](http://www.lausanne.ch/apal)

### Secteur des naturalisations, Service de la population (Sektori i natyralizimeve, Shërbimi i popullsisë)

Case postale, 1014 Lausanne, tel. 021 316 45 91, [www.vd.ch/naturalisation](http://www.vd.ch/naturalisation)  
Central telefonik: nga e hëna deri të premten, ora 9.00-11.30

## VOTRE VILLE, VOTRE VIE, VOTRE VOIX

Qyteti i Lozanës ju propozon një sërë vizitash me udhërrëfyes, si dhe një seancë informimi për përdorimin e materialit të votimit. Po ashtu, një autobus i posaçëm (bus citoyen) përshkon lagjet e qytetit. Gjatë këtyre takimeve që janë falas, ju do të zbuloni jetën politike lozaneze, do të vizitoni institucionet dhe do të kuptoni kështu lidhjet që ekzistojnë midis komunave, Kantonit dhe Konfederatës.

Broshurën dhe kalendarin mund t'i shkarkoni në sitin [www.lausanne.ch/bli](http://www.lausanne.ch/bli) > Citoyenneté



# Kultura, argëtimet dhe sporti

Lozana është e shumëllojtë dhe e gjallë; ajo propozon një paletë të gjerë veprimtarish artistike dhe veprimtari të shumta argëtuese. Nga ana tjetër, kryeqyteti olimpiq mbështet në mënyrë aktive sportin dhe lëvizjen e njerëzve në kuptimin e gjerë të fjalës.

## Kultura

Qyteti jo vetëm është një vend me të cilin lidhen shumë emra të mëdhenj të muzikës klasike dhe të skenës lirike, por ai shkëlqen edhe në fushën e muzikës së sotme dhe të xhazit; ai ka shumë salla koncerti të specializuara, të cilat propozojnë programe të bollshme e të shumëllojshme.

Këtu bie në sy gjithashtu se oferta në fushën e baletit dhe teatrit është shumë ngjeshur. Veç performimeve bashkëkohore, skenave klasike, humorit dhe publikut në moshë të re, Qyteti dallohet edhe si vend i krijimtarisë me rrezatim ndërkombëtar.

Rreth njëzetë muze, disa prej të cilëve janë të vetëm në botë, kontribuojnë gjithashtu në pasurimin e jetës artistike lozaneze, me ekspozita me tematika shumë të larmishme, të cilat mund të vizitohen përgjatë tërë vitit.

Të gjithë muzetë (me përjashtim të Muzeut olimpiq dhe të Fondacionit të Hermitazhit (Fondation de l'Hermitage) janë falas, të shtunën e parë të çdo muaji.

Karta "Cultissime" është një pasaportë kulture dhe argëtimi për 18-25 vjeçarët. Kjo pasaportë u lejon institucioneve pjesëmarrëse në projekt blerjen e biletave me rreth 50% të çmimit dhe hyrjen falas në muzetë komunalë të Lozanës dhe Pully-së.

**Blini pasaportën e kulturës**

[www.carte-cultissime.ch](http://www.carte-cultissime.ch)

**Lista e muzeve**

[www.lausanne.ch/musees](http://www.lausanne.ch/musees)

**Vizita e pasurive kulturore me udhërrëfyes**

[www.lausanne.ch/visites](http://www.lausanne.ch/visites)

**Bibliotekat e qytetit**

[www.lausanne.ch/biblio](http://www.lausanne.ch/biblio)

## Argëtimet

Zyra "Info Cité" i regjistron të gjitha ngjarjet kulturore që zhvillohen në Lozanë. Kalendar i sitit të Internetit të Qytetit të Lozanës jua mundëson kërkimin e tyre, sipas temës, vendit apo datës.

Zyra e turizmit, përmes sitit të saj në disa gjuhë, Instagramit dhe pikave të saj të informimit turistik në Ouchy, në stacionin e trenit e në Katedrale, ofron informacione të shumta mbi veprimtaritë argëtuese.

**Info Cité**

[www.lausanne.ch/infocite](http://www.lausanne.ch/infocite)

**Kalendar i Qytetit**

[www.lausanne.ch/agenda](http://www.lausanne.ch/agenda)

**Lausanne Tourisme (Turizmi Lozanë)**

[www.lausanne-tourisme.ch](http://www.lausanne-tourisme.ch)

## Sporti

Lozana, si kryeqytet olimpiq dhe administrativ i sportit, mbështet në mënyrë aktive sportin në të gjitha format e tij, nga sporti për të gjithë deri te sporti elitari. Në Lozanë, ka 300 klube sportive dhe zhvillohen mbi 50 ngjarje sportive, siç janë 20 kilometërshi i Lozanës (20KM de Lausanne) dhe gara atletike Athletissima, që destinohen për një publik të shumëllojshëm Qyteti i Lozanës propozon gjithashtu infrastruktura të shumta sportive, me hyrje të lirë për popullsinë. Pra, në Kryeqytetin olimpiq, oferta sportive është shumë e pasur dhe u përgjigjet kërkesave të secilit, përgjatë tërë vitit.

**Ngjarjet sportive**

[www.lausanne.ch/manifestations-sportives](http://www.lausanne.ch/manifestations-sportives)

Qendrat sportive [www.lausanne.ch/installations-sportives](http://www.lausanne.ch/installations-sportives)

**Klubet sportive**

[www.lausanne.ch/clubs-sportifs](http://www.lausanne.ch/clubs-sportifs)

# Transportet dhe lëvizshmëria

Lozana i jep përparësi lëvizjes së qëndrueshme dhe u siguron banorëve të saj mundësi të shumta për t'u zhvendosur me metro, me autobus, me biçikletë apo në këmbë.

## Metroja, autobusët, trenat dhe parkingjet

Metroja e parë automatike në Zvicër, m2-shi, lidh për 18 minuta jugun me veriun e qytetit të Lozanës, (Ouchy-Croisettes); ky bosht i transportit qytetës lidhet edhe me rrjetin e autobusëve t1 dhe me linjat hekurudhore CFF.

Nga stacioni i Flonit nisen dy linja të tjera hekurudhore: treni i linjës LEB Lozanë- Eshalan-Bershe (Lausanne-Echallens-Bercher) në drejtim të veriut dhe metroja m1, në drejtim të qytetit Renens.

Transportet e krenjt kantonit janë organizuar me zona tarifore (mobilis-vaud.ch); Lozana përkton me zonat 11 dhe 12. Duke filluar nga 15 zona, keni qasje në të gjitha zonat.

Për automjetet, ka shumë parkingje që gjenden në dyert e qytetit e që kombinohen me mjetet e transportit publik (parkings-relais P+R).

Banorët mund të blejnë një kartë rezidenti (macaron) që lejon zgjatjen e kohës së parkimit në lagjen e tyre.

**Transports publics de la région lausannoise**

**(Transportet publike të rajonit lozanez)**

**Centre clientèle Flon (Qendra e klientelës Flon)**

Place de l'Europe 5b, 1003 Lausanne, e hënë - e premte ora 7.00-19.00,

të shtunën 9.00-18.00

Shërbimi i klientit 021 621 01 11 (bisedë me tarifë normale).

**Chemins de fer fédéraux suisses – CFF (Hekurudhat federale zvicerane)**

[www.cff.ch](http://www.cff.ch), tel. 0848 44 66 88 (0.08 Fr./min.)

**Services des routes et de la mobilité (Shërbimet e rrugëve dhe lëvizshmërisë)**

[www.lausanne.ch/rm](http://www.lausanne.ch/rm)

**Office de la circulation et du stationnement (Zyra e qarkullimit dhe parkimit)**

Rue Saint-Martin 31, case postale 5354, 1002 Lausanne, tel. 021 315 38 00

[stationnement@lausanne.ch](mailto:stationnement@lausanne.ch), [www.lausanne.ch/macarons](http://www.lausanne.ch/macarons)

## Biçikleta

Biçikleta ju çliron nga problemet e parkimit e të bllokimit të trafikut. Në itinerare më të shkurtra se 4 kilometra, në qytet, biçikleta është më e shpejtë se automjetet. Në dispozicion keni një hartë të itinerareve të rekomanduara.

Përdorimi i biçikletave elektrike, të cilat po bëhen gjithmonë e më të shumta, bën të mundur përshkrimin e largësive më të gjata dhe të pjerrësive më të mëdha. Qyteti subvencionon blerjen e biçikletave elektrike në masën 15% të çmimit (jo më shumë se 400 franga); ndërsa për moshën deri në 25 vjeç, masa e subvencionimit arrin në 30% të çmimit (deri në 800 franga e shumta).

**Service des routes et de la mobilité (Shërbimi i rrugëve dhe lëvizshmërisë)**

Délégué vélo (I deleguari për biçikletat)

Rue du Port-Franc 18, case postale 5354, 1002 Lausanne

Tel. 021 315 54 15, [velo@lausanne.ch](mailto:velo@lausanne.ch), [www.lausanne.ch/velo](http://www.lausanne.ch/velo)

**Subvencionet për biçikleta elektrike**

Kushtet dhe kërkesat në sitin [www.equiwatt.ch/mobilite-douce](http://www.equiwatt.ch/mobilite-douce)

## Këmbësorët

Ecja në këmbë është mënyra më e thjeshtë dhe më ekologjike për t'u zhvendosur në qytet. Prandaj janë bërë rregullime e përshtatje të shumta për të nxitur këtë mënyrë zhvendosjeje dhe për të ruajtur rehatinë e këmbësorëve: vendkalime për këmbësorët, itinerare të blerta, zgjerime të zonave këmbësore, etj.

**Service des routes et de la mobilité (Shërbimi i rrugëve dhe lëvizshmërisë)**

Délégué piétons (I deleguari për biçikletat)

Rue du Port-Franc 18, case postale 5354, 1002 Lausanne

Tel. 021 315 54 15, [pietons@lausanne.ch](mailto:pietons@lausanne.ch), [www.lausanne.ch/pietons](http://www.lausanne.ch/pietons)

## Lëvizshmëria për njerëzit me aftësi të kufizuara

Njerëzit me aftësi të kufizuara mund të gjejnë shërbime ndihme në sitin: [www.lausanne.ch/aineshandicapes](http://www.lausanne.ch/aineshandicapes), shkronja «T» për transportet ose në tel. 021 315 11 11.

## Taksitë

Programi falas Taksi Lozanë (Taxi Lausanne) ju lejon të porosisni një taksì në mënyrë të thjeshtë e ndërvepruese.

# Thelbësorja nga A-ja te Z-ja. Përmbledhës adresash

## Accueil pour enfants

### Bureau des naturalisations – APEMS

#### (Pritje për fëmijët në mjedis shkollor)

Place Chauderon 9, 1002 Lausanne  
E hënë - e premte ora 7.30-11.45, 13.00-17.00  
Tel. 021 315 68 33/08, [www.lausanne.ch/apems](http://www.lausanne.ch/apems)

## Registre civique (Regjistri zgjedhor)

### Bureau des naturalisations et registre civique

Place de la Palud 2, 1002 Lausanne  
E hënë - e premte ora 9.00-11.30, 14.00-16.00  
Tel. 021 315 22 33

## Administration cantonale

### (Administrata kantonale)

Tel. 021 316 21 11, [www.vd.ch](http://www.vd.ch)

## Administration communale

### (Administrata bashkiake)

Tel. 021 315 11 11, [www.lausanne.ch](http://www.lausanne.ch)

## Administration militaire

### (Administrata ushtarake)

#### Service de la sécurité civile et militaire

Place de la Navigation 6, 1110 Morges 1  
E hënë - e premte ora 7.30-11.45, 13.30-16.45  
E martë 7.30-18.30  
Tel. 021 316 47 40, [www.vd.ch/sscm](http://www.vd.ch/sscm)

## Assurance incendie et éléments naturels

### (Sigurimi kundër zjarrit dhe fatkeqësive natyrore)

#### Etablissement d'assurance contre l'incendie et les éléments naturels du Canton de Vaud – ECA

Rue Cité-Devant 12, 1005 Lausanne  
E hënë - e enjte ora 8.00-12.00, 13.30-17.00  
E premte ora 8.00-12.00, 13.30-16.30  
Tel. 0800 721 721, [www.eca-vaud.ch](http://www.eca-vaud.ch)

## Assurances sociales, allocations de naissance et de maternité, prestations complémentaires

### (Sigurimet shoqërore, alokacionet e lindjes dhe mëmësisë, ndihmat plotësuese)

Place Chauderon 7, 1002 Lausanne  
E hënë - e premte ora 8.30-11.45, 13.00-17.00  
Tel. 021 315 11 11  
[www.lausanne.ch/assurances-sociales](http://www.lausanne.ch/assurances-sociales)

## Bibliothèque municipale

### (Biblioteka komunale)

Place Chauderon 11, 1002 Lausanne  
E hënë, e martë, e enjte, e premte ora 12.00-19.30,  
e mërkurë ora 10.00-19.30,  
E shtunë ora 11.00-16.00, tel. 021 315 69 15  
[www.lausanne.ch/bibliotheque](http://www.lausanne.ch/bibliotheque)

## Contrôle des habitants (Regjistri i banorëve)

Rue du Port-Franc 18, 1002 Lausanne  
E hënë - e premte ora 8.00-12.00, 13.00-16.30  
Tel. 021 315 31 33, [www.lausanne.ch/ch](http://www.lausanne.ch/ch)

## Cours de français (liste)

### (Kurset e frëngjishtes (lista))

#### Bureau lausannois pour les immigrés – BLI

Place de la Riponne 10, 1002 Lausanne  
E hënë - e premte ora 8.00-12.00, 13.00-17.00  
Tel. 021 315 72 45, [www.lausanne.ch/bli](http://www.lausanne.ch/bli)

## Crèches – information et inscriptions

### (Çerdhet – informimi dhe regjistrimi)

#### Bureau d'information aux parents – BIP

Place Chauderon 9, 1002 Lausanne  
E hënë - e premte ora 8.30-11.30, 13.30-16.30  
Shërbim i gatshëm telefonik: e martë, e enjte, e premte ora 10.00-12.00  
tel. 021 315 60 00, [www.lausanne.ch/bip](http://www.lausanne.ch/bip)

## Déchets, recyclage (Mbetjet, riciklimi)

### Service de la propreté urbaine

Rue des Terreaux 33, 1002 Lausanne  
E hënë - e premte ora 8.00-12.00, 13.30-17.00  
Tel. 021 315 79 11  
[www.lausanne.ch/proprete-urbaine](http://www.lausanne.ch/proprete-urbaine)

## Eau information, contrôle

### (Uji, informimi dhe kontrolli)

#### Service de l'eau

Rue de Genève 36, 1002 Lausanne  
E hënë - e premte ora 7.00-11.30, 13.00-16.30  
Tel. 021 315 85 30, [www.lausanne.ch/eau](http://www.lausanne.ch/eau)

## Ecole – information et inscriptions

### (Shkolla - informimi dhe regjistrimet)

#### Service des écoles primaires et secondaires

Place Chauderon 9, 1002 Lausanne  
E hënë - e premte ora 7.30-11.45, 13.00-17.00  
(e mërkurë dhe e premte deri në orën 16.00)  
Tel. 021 315 64 11, [www.lausanne.ch/seps](http://www.lausanne.ch/seps)

## Etat civil (mariage, naissance...)

### (Gjendja civile - martesat, lindjet ...)

Me takim, tel. 021 557 07 07  
[www.vd.ch/etatcivil](http://www.vd.ch/etatcivil) ou  
[www.lausanne.ch/demarches](http://www.lausanne.ch/demarches)

## Spitali

### Centre hospitalier universitaire vaudois – CHUV

Rue du Bugnon 46, 1011 Lausanne  
Tel. 021 314 11 11, [www.chuv.ch](http://www.chuv.ch)

## Hôpital de l'Enfance (Spitali i Fëmijëve)

Chemin de Montétan 16, 1004 Lausanne  
Tel. 021 314 84 84, [www.hopital-enfance.ch](http://www.hopital-enfance.ch)

## Hôpital ophtalmique Jules Gonin

### (Konsulta të specializuara për sytë)

Avenue de France 15, 1004 Lausanne  
Tel. 021 626 81 11, [www.asile-aveugles.ch](http://www.asile-aveugles.ch)

## Impôts – Office de Lausanne

### (Tatimet - Zyra e Lozanës)

Rue Caroline 11 bis, 1014 Lausanne  
E hënë - e premte ora 8.30-11.30, 13.30-16.30,  
Tel. 021 316 23 11, [www.vd.ch/impots](http://www.vd.ch/impots)

## Impôts sur les chiens (Tatimet për qentë)

### Bureau des impôts

Place Chauderon 9, 1002 Lausanne  
Sportel: e hënë - e premte ora 13.00-16.00  
Permanence téléphonique (Shërbim i gatshëm telefonik): Ora 9.00-11.30, 13.30-16.00  
Tel. 021 315 43 11  
[www.lausanne.ch/impots](http://www.lausanne.ch/impots)

## Information au public – Info Cité

### (Informim publik – Info Site)

Place de la Palud 2, 1002 Lausanne  
E hënë - e premte ora 8.00-17.00  
Tel. 021 315 25 55  
[www.lausanne.ch/infocite](http://www.lausanne.ch/infocite)

## Intégration des immigrés

### (Integrimi i të imigruarve)

#### Bureau lausannois pour les immigrés – BLI

Place de la Riponne 10, 1002 Lausanne  
E hënë - e premte ora 8.00-12.00, 13.00-17.00  
Tel. 021 315 72 45  
[www.lausanne.ch/bli](http://www.lausanne.ch/bli)

## Interprétariat communautaire

### (Shërbimi i përkthyesve komunitarë)

#### Service Intermedia – Appartenances

Rue des Terreaux 10, 1003 Lausanne  
Tel. 021 341 12 50  
[www.appartenances.ch](http://www.appartenances.ch)

## Justice de Paix (Drejhtësia e Paqes –

### kompetente për çështje borxhesh, trashëgimie, për mbrojtjen e fëmijëve, etj.)

Côtes-de-Montbenon 8, 1014 Lausanne  
E hënë - e premte ora 8.00-11.30, 13.30-16.30  
Tel. 021 316 10 60  
[www.vd.ch/justice](http://www.vd.ch/justice)

**Lausanne Tourisme (Turizmi Lozanë)**  
**Gare CFF (Stacioni i trenit)**

Salla qendrore, çdo ditë  
ora 9.00-19h.00 (qershor-gusht), ora 9.00-18.00  
(shtator-maj)

**Ouchy**

Place de la Navigation 6, çdo ditë  
ora 9.00-19.00 (qershor-gusht), ora 9.00-18.00  
(shtator-maj)

**Katedrale**

Brenda ndërtesës, orari i hapjes  
mund të shikohet në linjë. Tel. 021 613 73 73  
www.lausanne-tourisme.ch

**Logements subventionnés,  
location appartements**

**(Banesa të subvencionuara, dhënie  
me gira e apartamenteve)**  
**Service du logement et des gérances**  
Place Chauderon 7, 1002 Lausanne  
E hënë - e premte ora 8.00-11.45, 13.00-16.30  
Tel. 021 315 74 11, www.lausanne.ch/slg

**Citycable – Service multimedia  
(Citycable – shërbim multimedia Internet,  
Televizion, Telefoni)**

Place de l'Europe 2, 1002 Lausanne  
Hapësira e klientëve: e hënë - e premte  
ora 9.00-18.30, e shtunë ora 9.00-17.00  
Tel. E hënë - e premte ora 8.00-17.00  
0842 841 841  
www.lausanne.ch/citycable

**Objets trouvés (Sendet e gjetura)**

Place de la Riponne 10, 1002 Lausanne  
E hënë - e premte ora 13.00-16.00  
Shërbim i gatshëm telefonik:  
E hënë - e premte ora 8.00-12.00  
tel. 021 315 33 85  
www.lausanne.ch/objets-trouvés

**Office régional de placement – ORP  
(Zyra rajonale e punësimit)**

Place Chauderon 9, 1002 Lausanne  
E hënë - e premte ora 7.30-11.45, 13.00-17.00  
Tel. 021 315 78 99, www.lausanne.ch/orp

**Orientimi shkollor e profesional  
Centre régional d'orientation scolaire  
et professionnelle Lausanne – OSP**

Rue de la Borde 3d, 1014 Lausanne  
Shërbim i gatshëm informimi i hapur për publikun,  
Pa takim. E hënë ora 13.15-17.00, nga e marta në  
të enjten  
Ora 13.30-17.00, të premten dhe në vigjilje të  
ditëve të pushimit: Ora 12.00-16.00  
Tel. 021 316 11 20, www.vd.ch/orientation

**Passeport, carte d'identité  
(Pasaportat, letrat e njoftimit)**

**Secteur des documents d'identité  
du Canton de Vaud**  
Voie du Chariot 3 (Flon), 1014 Lausanne  
Sportel: e hënë - e premte ora 7.30-17.30,  
e shtunë ora 7.30-16.30  
Telefon: Ora 8.00-12.00, 13.30-17.00  
Tel. 0800 01 12 91, www.vd.ch/passeport

**Permis de conduire  
(Lejet e drejtimit të automjeteve)**

**Service des automobiles  
et de la navigation du Canton de Vaud**  
Avenue du Grey 110, 1014 Lausanne  
Sportel: e hënë - e premte ora 7.15-16.15  
Telefon: e hënë - e premte ora 8.00-11.30,  
13.15-16.15  
tel. 021 316 82 10, www.vd.ch/san

**Permis de séjour (Lejet e qëndrimit)  
Contrôle des habitants**

Rue du Port-Franc 18 (Flon), 1002 Lausanne  
E hënë - e premte ora 8.00-12.00, 13.00-16.30  
Tel. 021 315 31 33  
www.lausanne.ch/ch

**Leje pune**

**Service de l'emploi**  
Rue Caroline 11, 1014 Lausanne  
Tel. 021 316 61 04  
www.vd.ch/emploi

**Police de Lausanne (Policia e Lozanës)**

Rue Saint-Martin 33, 1002 Lausanne  
Çdo ditë ora 24 orë në 24, tel. 021 315 15 15  
www.lausanne.ch/police

**Policlinique médicale universitaire et  
Unité des populations vulnérables – PMU  
(Poliklinika mjekësore universitare dhe Njësia  
e popullive të brishta)**

Rue du Bugnon 44, 1011 Lausanne  
Tel. 021 314 60 60  
Çdo ditë 24 orë në 24

Voie du Chariot 4 (Flon), 1003 Lausanne  
Tel. 021 314 90 90

Çdo ditë të javës, e hënë - e shtunë ora 7.00-21.00,  
të dielën dhe ditët e pushimit ora 9.00-19.00  
www.pmu-lausanne.ch

**Office des prestations funéraires lausannoises  
(Zyra lozaneze e shërbimeve funerale)**

Chemin du Capelard 5, 1007 Lausanne

**Centre funéraire de Montoie**

E hënë - e premte ora 7.30-18.30, e shtunë - e diel,  
ditët e pushimit ora 10.00-15.00  
Tel. 021 315 32 95

**Pompes funèbres officielles – PFO**

E hënë - e premte ora 7.30-12.00, 13.30-17.00  
tel. 021 315 45 45 (24 orë në 24)  
www.lausanne.ch/pfo

**Bureau des décès et des cimetières**

E hënë - e premte ora 7.30-12.00, 13.30-17.00  
tel. 021 315 32 75  
www.lausanne.ch/inhumations

**Services industriels: électricité, gaz,  
chauffage à distance, multimédia  
(Shërbimet industriale: elektricitet, gaz,  
ngrohje në largësi, multimedia)**

Place Chauderon 23, 1002 Lausanne  
E hënë - e premte ora 8.00-12.00, 13.00-17.00  
tel. 0842 841 841, www.lausanne.ch/sil

**Service social – information et accueil  
(Shërbimi shoqëror – informimi dhe pritja)**

**Centre social régional – CSR**  
Place Chauderon 4, 1002 Lausanne  
E hënë - e premte ora 8.30-11.45, 13.00-16.30,  
e mbyllur të enjten paradite, tel. 021 315 75 11  
www.lausanne.ch/csr

**Stationnement - macarons (Parkimi - Karta  
e rezidentit për parkim në lagje)**

**Office de la circulation et du stationnement**  
Rue Saint-Martin 31, 1002 Lausanne  
E hënë - e premte ora 7.30-17.00  
Tel. 021 315 38 00  
www.lausanne.ch/macarons

**Transports publics de la région lausannoise  
(Transportet publike të rajonit lozanez)**

**Centre clientèle Flon**  
Place de l'Europe 5b, 1003 Lausanne  
E hënë - e premte ora 7.00-19.00, e shtunë ora  
9.00-18.00  
**Shërbimi i klientëve**  
E hënë - e premte ora 7.30-19.00, 021 621 01 11  
(bisedë me tarifë normale). www.t-l.ch

**URGENCES (24H/24)  
(URGJENCAT (24 ORË NË 24))**

**Thirrje në rast urgjence jetësore: tel. 144**

**Mjeku roje: tel. 0848 133 133**

**Policia e shpëtimit: tel. 117**

**Zjarri: tel. 118**

## Gjendet në:

Shqip

Gjermanisht / deutsch

Anglisht / english

Arabisht / العربية

Boshnjakisht-kroatisht-serbisht /  
bosanski-hrvatski-srpski

Spanjisht / español

Frëngjisht / Français

Italisht / italiano

Portugalisht / português

Tigrinja / ትግርኛ

### **Bureau lausannois pour les immigrés**

Place de la Riponne 10  
case postale 5032  
1002 Lausanne  
T +41 21 315 72 45  
[www.lausanne.ch/bli](http://www.lausanne.ch/bli)  
[bli@lausanne.ch](mailto:bli@lausanne.ch)

### **Info Cité**

Place de la Palud 2  
case postale 6904  
1002 Lausanne  
T +41 21 315 25 55  
[infocite@lausanne.ch](mailto:infocite@lausanne.ch)